

Letërnjoftimi i Komunës së

**ISTOGUT**

**2014**

Maj, 2015





## Fakte


- Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Istogut ishin afro 985 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje te konsiderueshme në krahasim me vitin 2013.
- Vitin 2014 Istogu ka përmbyllur me 1.912 të punësuar në sektorin publik, 24 më shumë se sa një vit më parë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Istogu ka edhe 15 të punësuar me kontratë mbi vepër.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 644 persona, prej tyre 529 mësimdhënës. Në Komunën e Istogut raporti nxënës/mësimdhënës është 34.0. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 141 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Istogut është 284.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Në Komunën e Istogut funksionojnë 654 biznese, prej tyre janë 64 biznese me veprimtari prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 141 biznese të reja, një numër më i ulët krahasuar me vitin paraprak.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 43 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Istogu gjatë vitit 2014 ka pasur 608 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë, del se në Istog rreth 6.5% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Haki Rugova gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 19 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z.Rugova ka arritur të realizoj 26% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

## 2 Qeverisja komunale

Edhe në zgjedhjet e fundit lokale (2013) qytetarët e Komunës së Istogut ia besuan votën dhe i vazhduan mandatin edhe për katër vite të ardhshme z. Haki Rugova nga radhët e LDK-së.


Në Komunën e Istogut kanë votuar gjithsej 20,137 apo rreth 45% qytetarë me të drejtë vote. Haki Rugova ka marr 51%, ndërsa kandidatja e cila u radhit e dyta ishte znj. Donika Kadaj-Bujupi (AAK), mori 28.25% të votave.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: LDK 12 ulëse, AAK-LDD gjashtë ulëse, PDK katër ulëse dhe VV, AKR, Arif Elshani, G. I. Srpska dhe Iniciativa Qytetare Boshnjake e Istogut me nga një ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Istogut në bazë të zgjedhjeve 2013



### 3 Buxheti i Komunës së Istogut


Më 2014, Komuna e Istogut kishte buxhet prej 8.1 milion eurove, një zvogëlim prej afër 163 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 957 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 2.2 milion euro.

**Grafikoni nr. 3** Buxheti total i Komunës së Istogut dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Istogut ishin afro 985 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje te konsiderueshme në krahasim me vitin 2013.

**Grafikoni nr.4** Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Istogut 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 29% të të hyrave të përgjithshme.

**Grafikoni nr.5** Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Istogut ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Klina, Malisheva, Kamenica, Kaçaniku, etj., ndërsa më pak se sa Istogu, Rahoveci, Vitia, etj.

**Grafikoni nr.6** Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, ka pasur ngritje në disa prej këtyre kategorive si ajo e shpenzimeve për telefoni mobile dhe shpenzimeve për dreka zyrtare në krahasim me një vit më parë, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.


**Grafikoni nr. 7** Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Instituti GAP

Komuna e Istogut gjatë vitit 2014 për rrymë elektrike ka shpenzuar 82,867 euro, apo 5,937 euro më pak se sa viti paraprak. Në përgjithësi shpenzimet komunale kanë shënuar ulje të shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak.


**Grafikoni nr. 8** Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



## 4 Të punësuarit në sektorin publik

Vitin 2014 Istogu ka përmbyllur me 957 të punësuar në sektorin publik, 24 më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar 20 shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës. Ndërsa në sektorin e arsimit është zvogëluar numri për 14 punëtor.


**Grafikoni nr.9** Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Istogut





Istogu ka të punësuar 170 punonjës në administratë, apo një shërbyes civil për 236 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Istogu ka edhe 15 të punësuar me kontratë mbi vepër. Të angazhuarit me kontratë mbi vepër janë kryesisht roje.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 644 persona, prej tyre 529 mësimdhënës. Në Komunën e Istogut raporti nxënës/mësimdhënës është 34.0. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Istogut



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 141 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Istogut është 284.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale


Në Komunën e Istogut funksionojnë 654 biznese, prej tyre janë 64 biznese me veprimtari prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 141 biznese të reja, një numër më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.

**Grafikoni nr.14** Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 43 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

**Grafikoni nr.15** Llojet e bizneseve të shuara 2014



## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Haki Rugova gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 19 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z. Rugova ka arritur të realizoj 26% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

**Grafikoni nr.16** Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

